



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 57 datë 26-06-2025

“MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale ,bazuar në dispozitat ligjore,në Ligjin nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve 3, 4, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384 , datë 12.06.2019,“Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362,datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”,VKM nr.301, datë 15.04.2020 ”Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB Nr.97 datë 27.07.2023 “ Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit subvencioni i qirasë në tregun e lirë ,VKB Nr.165 datë 24.12.2024 “Mbi miratimin e vlerës mesatare të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë”,VKB Nr. 176, datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2025 dhe të PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë”dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Të miratojë përfitues nga programi i “Subvencionimit të Qirasë” 1(një) familje aplikante, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencioni i qirasë do t’i jepet përfituesve që nga data e miratimit të listës bashkëngjitur nga Këshilli Bashkiak.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike .

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NACI

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 27-06-2025



Tabela nr.3 e Vendimit
Lista familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë 2025

Nr	Emri / Atesia / Mbiemri	<u>Kateg oria sipas nenit 16. të ligjit nr.22/ 2018</u>	<u>Përbëria Familjare</u>	<u>Struktura e Apartamentit</u>	<u>Sipërfaqe e Apartamentit</u>	<u>Qiraja mes. e apart. në treg për strukturen që i takon familjes</u>	<u>Të ardhurat familjare mujore</u>	<u>Kategoria (sipas pikës 45. e nenit 2, të ligjit 22/2018)</u>	<u>Aftësia përballuese sipas nenit 3 të ligjit</u>	<u>Qiraja e përballueshme (h*i)</u>	<u>Subvencioni në muaj (g-k)</u>	<u>Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia (0.4*1)</u>	<u>Shuma që kërkohej nga buxheti (0.6*1)</u>
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n
1	Feti Hysni Osmanllari	A/5	5	2+1	74	15,000	22,346	Sh.të.ulta	15%	3,352	11,648	4,659	6,989
	Shuma Mujore/lekë												
	Shuma Vjetore/ lekë 6 muaj											27,954	41,934
													69,888


KRYETARI
Ana VERUSHI